

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Versioni i rishikuar: 1/1 qershor, 2017 Data e printimit: 20 qershor, 2017

1/2 Tetor 2019

1/3 Nentor 2022

1/4 Dhjetor 2025

1. IDENTIFIKIMI I SUBSTANCËS/PËRZIERJES DHE KOMPANISË		
1.1 Identifikimi i Substancës	Çimentoja Portland, kompozite: CEM II / B-M (W-L) 42.5R CEM II / B-M (W-L) 52.5N CEM II / C-M(W-P-L)42.5N	
1.2 Përdorimet e identikuara relevante të substancës ose përzierjes dhe përdorimet që nuk rekomandohen	Çimentot përdoren në instalimet industriale për prodhimin/formulimin e lidhjeve hidraulike për punën e ndërtimit, të tilla si betoni me përzierje të gatshme, llaçet, suvat, finot, allçitë si dhe betoni i parapërgatitur. Çimentot e zakonshme dhe përzierjet që përmbajnë çimento (lidhjet hidraulike) përdoren në industri, nga profesionistët si dhe nga konsumatorët në punën ndërtimore, brenda dhe jashtë. Përdorimet e identikuara dhe përzierjet që përmbajnë çimento mbulojnë produktet e thata dhe produktet në suspensione të lëngshme (qiriq). Shikoni pjesën 16.2 për më tepër informacione lidhur me përshkruesit e përdorimit dhe kategoritë. Çdo përdorim që nuk përmendet këtu, nuk rekomandohet.	
1.3 Prodhuesi	Titan Sharrcem Sh.P.K Adresa: St. Adem Jashari 71510 Hani Elezit, Kosovo Telephone number: 00383 290 385 500 Health and safety: bujar.aliu@sharrcem.com Environment: zenulla.burniku@sharrcem.com Quality: teodor.zguro@sharrcem.com	
1.4 Telefoni emergjent	00383 38 500 600	
Telefonat tjerë të nevojshëm	QKUK. Hospital Pristina : 00383 38 500 600 Oret e operimit: 24 / 7	
2. IDENTIFIKIMI I RREZIQEVE		
2.1. Klasifikimi i substancës ose përzierjes		
2.1.1 Sipas rregullores (EC) Nr. 1272/2008		
Klasa e rrezikut	Rreziku Kategoria	Pasqyrat e rrezikut
Pezmatimi i lëkurës	2	H315: Shkakton pezmatim të lëkurës
Dëm serioz të syve/pezmatim të syve	1	H318: Shkakton dëm serioz të syve

Ndjeshmëri të lëkurës	1B	H317: Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lëkurës
Pezmatim i traktit respirativ nga ekspozimi ndaj toksicitetit të organit specifik	3	H335: Mund të shkaktojë pezmatim respirativ

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC) Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: **Çimentoja**

2.2 Elementet e emërimit

2.2.1 Sipas rregullores (EC) Nr. 1272/2008

Piktogramet e Rrezikut



Vëmendja ndaj Rrezikut

Pasqyrat e rrezikut

H318 Shkakton dëm serioz të syve
 H315 Shkakton pezmatim të lëkurës
 H317 Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lëkurës
 H335 Mund të shkaktojë pezmatim respirativ

Pasqyrat parandaluese

P102: Të mbahet larg fëmijëve P264: Të lahet tërësisht pas manipulimit
 P272: Teshat e kontaminuara të punës nuk duken të lihen në vend të punës P280: Vishni doreza mbrojtëse/tesha mbrojtëse/mbrojtëse të syve/mbrojtëse të fytyrës
 P305+P351+P338+P310: NËSE NË SY: Shpërlani me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni thjerrëzat, nëse i keni dhe është lehtë për t'i hequr. Vazhdoni me shpëlarje. Menjëherë thirrni QENDRËN E HELMEVE ose mjekun
 P302+P352+P333+P313: NËSE NË LËKURË: Të lahet me shumë sapun dhe ujë. Nëse ndodh pezmatimi i lëkurës ose skuqja: Merrni këshillë/vëmendje mjekësore
 P261+P304+P340+P312: T'i shmangeni inhalimit të pluhurit/tymit/gazit/mjegullës/avujve/spërkatësit. NËSE E INHALONI: Largoni viktimën te një vend ku ka ajër të pastër dhe mbani në pozitë që është e rehatshme për frymëmarrje. Thirrni QENDRËN E HELMEVE ose mjekun nëse nuk ndjeheni mirë.
 P321: Trajtim specifik
 P362: Zhvishni teshat e kontaminuara dhe lani ato para se t'i përdorni prapë
 P501: Hidhni përmbajtjet/kontejnerin sipas rregullave në fuqi

Informacione plotësuese

Kontakti i lëkurës me çimento të lagësht, beton të freskët ose llaç mund të shkaktojë pezmatim, dermatit ose djegie. Mund të shkaktojë dëm të produkteve të prodhuara nga alumini ose metalet tjera jo fisnike.

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: **Çimentoja**

2,3. Rreziqet tjera

Çimentoja nuk i përmbush kriteret për PBT ose vPvB sipas Shtojcës III të Reach (Rregullorja (EC) Nr. 1907/2006)

Produkti përmban agjent për zvogëlimin e kromatit. Si rrjedhojë, përmbajtja e kromit të tretshëm (VI) është më pak se 2

ppm. Nëse kushtet e ruajtjes nuk janë të duhura ose periudha e ruajtjes tejkalohet, efektiviteti i agjentit zvogëluar mund të zvogëlohet, dhe çimentoja mund të bëhet e ndjeshme për lëkurën (R43 resp. H317 ose EUH203).

3. PËRBËRJA/INFORMACIONET PËR PËRBËRËSIT

3.1. Përzierjet

Llojet e zakonshme të çimentos sipas standardeve EN 197-1 (çimentot e zakonshme):

Klinkeri i çimentos Portland 65-100%

Guri gëlqeror - 0-30%

Gjipsi - 3-10%

Agjenti zvoqëluar - 0-0,5%

Material ndihmës për bluarje - 0-0,05%

Komponentët që paraqesin rreziqet ndaj shëndetit dhe mjedisit

Përbërësi	% [pesha]	EC nr.	CAS nr.	REACH Nr. i Regjistrimit	Rregullorja e Klasifikimit 1272/2008	
Klinkeri i çimentos Portland	50-100%	266- 043.-4	65997- 15-1	Përjashtuar nga regjistrimit	Pezmatimi i lëkurës 2	H315
					Ndjeshmëria e lëkurës 1B	H317
					Dëmi i syve 1	H318
					STOT SE 3 - Ekspozimi ndaj toksicitetit të organeve specifike	H335
					Pezmatimi i lëkurës 2	H315

Pluhuri i qyngjit	0,1-5%	270-659-9	68475-76-3	01-2119486767-17-xxxx	Ndjeshmëria e lëkurës 1B	H317
					Dëmi i syve	H318
					STOT SE 3 - Ekspozimi ndaj toksicitetit të organeve specifike	H335
Të tjera (agjenti zvolgëlues dhe materiali ndihmës për bluarje)	0-0,5% 0-0,05%	Nën kufijtë e përqendrimit të përcaktuar në CLP 1272/2008				

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: **Çimentoja**

° Pjesa individuale e numrit të regjistrimit mund të anashkalohet nga furnizuesi i përzierjes me kusht që:

(a) Ky furnizues merr përgjegjësinë për ta dhënë numrin e plotë të regjistrimit sipas kërkesës për qëllime të zbatimit, ose nëse

Numri i plotë i regjistrimit nuk është në dispozicion të tij, për ta përcjellë kërkesën te furnizuesi i tij, në pajtim me pikën (b); dhe

(b) Ky furnizues ia ofron numrin e plotë të regjistrimit autoritetit të Shtetit Anëtar që është përgjegjës për zbatim (në tekstin e mëtejme

i referuar si "autoriteti zbatues") brenda 7 ditëve pas kërkesës, të pranuar ose drejtpërdrejtë nga autoriteti zbatues ose të përcjellë nga

pranuesi i tij, ose, nëse numri i plotë i regjistrimit nuk është në dispozicionin e tij, ky furnizues do ta përcjellë kërkesën te furnizuesi i tij brenda 7 ditëve sipas

kërkesës dhe në të njëjtën kohë e informon autoritetin zbatues për të.

Kjo nuk zbatohet për përzierjet e importuara.

4. MASAT E NDIHMËS SË PARË

4.1 Përshkrimi i masave të ndihmës së parë

Shënime të përgjithshme

Nuk ka nevojë për pajisjeve për mbrojtje personale për reaguesit e ndihmës së parë. Punëtorët e ndihmës së parë duhet t'i shmangen kontaktit

me çimenton e lagësht ose përzierjet që përmbajnë çimenton e lagësht.

Pas kontaktit me sy

Mos i fërkoni sytë për ta shmangur dëmin e mundshëm të korneas si rezultat i stresit mekanik.

Hiqni thjerrëzat nëse i keni. Uleni kokën kah syri i lënduar, hapeni kapakun e syrit sa më shumë dhe pastroni syrin(sytë)

menjëherë duke e shpërlarë shumë me ujë të pastër për së paku 20 minuta për largimin e të gjitha grimcave.

Shmanguni pastrimit të grimcave në syrin e pa lënduar. Nëse është e mundur, përdorni ujë izotonik (0.9% NaCl). Kontaktoni një specialist të

mjekësisë profesionale ose një specialist të syrit.

Pas kontaktit me lëkurë

Për çimenton e thatë, largoni dhe shpërlani me shumë ujë.

Për çimenton e lagësht, lajeni lëkurën me shumë ujë.

Largoni veshjet, mbathjet, orët e kontaminuara dhe pastroni shumë para se t'i ripërdorni.

Kërkoni trajtim mjekësor në të gjitha rastet e pezmatimit ose djegieve.

Pas inhalimit

Vendoseni personin në ajër të pastër. Pluhuri në fyt dhe kanalet e hundës duhet të pastrohet në mënyrë spontane.

Kontakti

Mjekun nëse pezmatimi vazhdon ose nëse krijohet më vonë ose nëse vazhdon sikleti, kollitja ose simptomat tjera.

Pas tretjes

Mos e nxitni vjelljen. Nëse personi është i vetëdijshëm, pastroni gojën me ujë dhe i jepni shumë ujë për të

pirë. Kërkoni ndihmë të menjëhershme mjekësore ose kontaktonin qendrën kundër helmimit.

4.2. Simptomat dhe efektet më të rëndësishme, si akute ashtu edhe të vonuara

Sytë: Kontakti i syve me çimento (të thatë ose të lagësht) mund të shkaktojë lëndime serioze dhe me gjasë të pakthyeshme.

Lëkura:

Çimentoja mund të ketë një efekt pezmatues në lëkurën e lagësht (për shkak të djersitjes ose lagështisë) pas kontaktit të zgjatur ose mund të shkaktojë dermatit pas kontaktit të përsëritur.

Kontakti i zgjatur i lëkurës me çimento të lagësht ose beton të lagësht mund të shkaktojë djegie serioze sepse ato zhvillohen

pa u ndjerë dhembja (për shembull kur gjunjëzoheni në beton të lagësht madje edhe me pantallona veshur).

Për më tepër hollësi shikoni Referencën (1).

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Versioni i rishikuar: 1/1 qershor, 2017 Data e printimit: 20 qershor, 2017

Inhalimi: Inhalimi i vazhdueshëm i pluhurit ose çimentos së zakonshme përgjatë një kohe të gjatë rrit

rrezikun e shkakimit të sëmundjes së mushkërive.

Mjedisi: Gjatë përdorimit normal, çimentoja e zakonshme nuk është e rrezikshme për mjedisin.

4.3. Treguesi i nevojës për ndonjë vëmendje të menjëhershme mjekësore dhe trajtim special

Kur ta kontakti mjekun, merreni këtë SDS me vete.

5. MASAT PËR LUFTIMIN E ZJARRIT

5.1 Mediumet për fikje të zjarrit

Çimentot e zakonshme nuk janë të djegshme.

5.2 Rreziqet e veçanta që burojnë nga substanca ose përzierja

Çimentot nuk djegen dhe nuk shpërthejnë dhe nuk e ndihmojnë ose mbështesin djegien e materialeve tjera.

5.3 Këshillat për zjarrfikësit

Çimentoja nuk paraqet rreziqe që ndërlidhen me zjarrin. Nuk ka nevojë për pajisjeve të veçanta mbrojtëse për zjarrfikësit.

6. MASAT E LIRIMIT AKSIDENTAL

6.1. Parandalimet personale, pajisjet mbrojtëse dhe procedurat e emergjencës

6.1.1 Për personelin jo-emergjent

Vishni pajisjet mbrojtëse sikurse përshkruhen në Pjesën 8 dhe zbatoni këshillën për manipulim dhe përdorim të sigurt

siç përcaktohet në Pjesën 7.

6.1.2 Për reaguesit emergjent

Procedurat e emergjencës nuk nevojiten.

Mirëpo, mbrojtja respirative është e nevojshme në situatat me nivele të larta të pluhurit.

6.2 Parandalimet mjedisore

Mos e hidhni çimenton në sistemet e kanalizimit ose në trupat ujore (p.sh. përroje)

6.3 Metoda dhe materiali për kontrollim dhe pastrim

Mblidheni derdhjen në një gjendje të thatë nëse është e mundur.

Çimentoja e thatë

- ✓ Përdorni metodat e pastrimit të tilla si pastrimi me vakum ose ekstraktimi me vakum (njësitë industriale portabël,

të pajisura me filtrat të ajrit me efikasitet të lartë (filtrat EPA dhe HEPA, EN 1822-1:2009) ose teknikën ekuivalente (që

nuk shkaktojnë shpërndarjen e ndotësve në ajër. Kurrë mos përdorni ajër të kompresuar.

- ✓ Në mënyrë alternative, pastroni pluhurin me fshesë, fshesë të lagët ose përmes spërkatësve apo zorrëve të ujit

(pastrim i lehtë për parandalimin shpërndarjes së pluhurit në ajër) dhe largoni substancat gjysmë të lëngshme. Nëse nuk është e mundur, largoni substancat gjysmë të lëngshme me ujë (shikoni Çimentoja e lagësht).

- ✓ Kur pastrimi i lagësht ose pastrimi i zakonshëm nuk është i mundur dhe vetëm pastrimi i thatë me brusha mund të bëhet

sigurohuni që punëtorët të pajisen me pajisje të duhura për mbrojtje personale dhe parandaloni shpërndarjen e pluhurit.

Shmanguni inhalimit të çimentos dhe kontaktit me lëkurë. Vendosni materialet e derdhura në një kontejner. Ngurtësoni materialet para hedhjes sikurse përshkruhet në Pjesën 13.

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Çimentoja e lagësht

Pastroni çimenton e lagësht dhe vendoseni në një kontejner. Lëreni materialin të thahet dhe ngurtësoni atë para hedhjes sipas përshkrimit në Pjesën 13.

6.4 Referencë në pjesët tjera

Shikoni pjesët 8 dhe 13 për më tepër hollësi.

7. MANIPULIMI DHE RUAJTJA

Mos manipuloni ose ruani materialet afër ushqimit dhe pijeve ose materialeve që prodhojnë tym.

7.1 Masat parandaluese për manipulim të sigurt

7.1.1 Masat mbrojtëse

Zbatoni rekomandimet ashtu siç përcaktohen në Pjesën 8. Për pastrimin e çimentos së thatë shikoni paragrafin 6.3.

Masat për parandalimin e zjarrit

Nuk zbatohet.

Masat për parandalimin e aerosolit dhe prodhimin të pluhurit

Mos fshini me fshesë. Përdorni metodat e pastrimit të thatë të tilla si pastrimi me vakum ose ekstraktimi me vakum, që

nuk shkaktojnë shpërndarjen e substancave në ajër.

Për më tepër informacione, referohuni udhëzimeve praktike të miratuara sipas Marrëveshjes së Dialogut

Social për Mbrojtjen e Shëndetit të Punëtorëve përmes Manipulimit të Mirë dhe Përdorimit të Silicit Kristalor dhe Produkteve që e Përmbajnë

atë, nga shoqatat sektoriale evropiane për punonjës dhe punëdhënës, në mesin e të cilave Është CEMBUREAU. Këto praktika

për manipulim praktik mund të gjenden në linkun vijues: [http://www.nepsi.eu/agreement-good-practiceguide/](http://www.nepsi.eu/agreement-good-practiceguide/good-practice-guide.aspx)

good-practice-guide.aspx.

Masat për mbrojtjen e mjedisit

Nuk ka masa të veçanta

7.1.2 Informacionet për higjienën e përgjithshme profesionale

Mos manipuloni ose ruani materialet afër ushqimit dhe pijeve ose materialeve që prodhojnë tym. Në mjediset me pluhur, vendoseni maskën e pluhurit dhe syzet mbrojtëse.

Përdorni dorezat mbrojtëse për ta shmangur kontaktin me lëkurë.

7.2 Kushtet për ruajtje të sigurt, përfshirë ndonjë pajtueshmëri

Çimentoja në sasi të mëdha duhet të ruhet në silose që janë rezistente ndaj ujit, të thata (dmth. me kondenzim

të brendshëm minimal), të pastra dhe të mbrojtura nga kontaminimi.

Rreziku nga zënia e frymës: Për parandalimin e zënies së frymës, mos hyni në hapësira të mbyllura, të tilla si silosi, hambari

Kamioni, apo kontejnerë tjerë për ruajtje apo hapësirë që ruan ose përmban çimento pa i marrë masat e duhura të sigurisë. Çimentoja mund rritet në sasi ose të ngjitet në muret e hapësirës së mbyllur. Çimentoja mund të grisitet, shembet ose të rrëzohet papritmas.

Produktet e paketuara duhet të ruhen në thasë të mbyllur dhe të mos jetë në kontakt me tokën si dhe në kushte të ftohta dhe të thata

dhe të mbrojtura nga thatësira e tepërt për ta shmangur degradimin e cilësisë. Thasët duhet të vendosen në një mënyrë të qëndrueshme.

Mos përdorni kontejnerë të aluminit për ruajtje ose transport të përzierjeve që përmbajnë çimento të lagësht për shkak të papajtueshmërisë së materialeve.

7.3 Përdorimi i fundit specifik

Nuk ka informacione shtesë për përdorimet e fundit specifike (shikoni pjesën 1.2)

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Versioni i rishikuar: 1/1 qershor, 2017 Data e printimit: 20 qershor, 2017

8. KONTROLLET E EKSPOZIMIT/MBROJTJA PERSONALE

8.1 Parametrat e kontrollit

<i>Vlerat e kufirit të ekspozimit</i>	<i>Vlera (si 8 h T_{EA}), mg/m³</i>	<i>Referenca ligjore</i>
Vlerat e kufirit të ekspozimit për pluhurin e çimentos në mjedisin e punës	10	Nr 537 i Aneksit të Rregullores Nr. 13/2003 rregullon mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet lidhur me ekspozimin në vendin e punës ndaj agjentëve të dëmshëm kimik

Inhalimi DNEL₁ (8h): 10 mg/m³ DNEL

dermal: nuk zbatohet
DNEL oral: nuk është relevant
DNEL i referohet pluhurit respirativ.

Për punëtorët, nuk zbatohet DNEL për ekspozim dermal, as nga studimet e rrezikut njerëzor e as nga përvoja njerëzore. Pasi që çimentot klasifikohen si pezmatuese ndaj lëkurës dhe syve, ekspozimi dermal duhet të minimizohet përdoruesit është i realizueshëm në aspektin teknik.

Uji PNEC₂ : nuk zbatohet për sedimentin PNEC: nuk zbatohet për dheun PNEC: nuk zbatohet

Vlerësimi i rrezikut të ndarjeve mjedisore bazohet në ndikimin e pH të fituar në ujë. Ndryshimet e mundshme të pH në ujin sipërfaqësor, ujin tokësor dhe mbeturinave ujore STF nuk duhet ta ngrisin vlerën 9.

8.2 Kontrollat e ekspozimit

Për secilin PROC individual, përdoruesit mund të zgjedhin nga opsioni A) ose B) në tabelën e mëposhtme sipas mënyrës që më së miri i përshkruan situatën specifike. Nëse një opsion përzgjidhet, atëherë opsioni i njëjtë duhet të zgjidhet në tabelën nga pjesa "8.2.2 Masat individuale mbrojtëse të tilla si pajisjet personale të mbrojtjes". Specifikimi i pajisjeve për mbrojtje respirative. Vetëm kombinimet mes A) - A) dhe B) - B) janë të mundshme.

8.2.1 Kontrollat e duhura inxhinjerike

Masat për zvogëlimin e prodhimit të pluhurit dhe shmangies së përhapjes së pluhurit në mjedis të tilla si largimi i pluhurit ventilimi dhe metodat e pastrimit të thatë që nuk shkaktojnë shpërndarjen e ndotësve në ajër.

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Versioni i rishikuar: 1/1 qershor, 2017 Data e printimit: 20 qershor, 2017

A) Kontrolltet e duhura inxhinjerek - çimentoja: inhalimi DNEL i 10 mg/m³

SHF RYT ËZI MI	Proc*	Ekspozimi	Kontrollet e lokalizuara	Efikasiteti
Prodhimi industrial/formulimi i ndërtesës hidraulike dhe materialeve ndërtimore.	2, 3	Kohëzgjatja nuk kufizohet (deri 480 minuta për ndërrim, 5 ndërrime në javë)	Nuk kërkohet	-
	14, 26		A) ventilimi i përgjithshëm ose B) Ventilimi gjenerik lokal i shkarkimit të tymit	- 78 %
	5, 8b, 9		A) ventilimi i përgjithshëm ose B) Ventilimi gjenerik lokal i shkarkimit të tymit	17 % 78 %
Përdorimet industriale të ndërtesës së thatë hidraulike dhe materialeve ndërtimore (brenda, jashtë)	2		Nuk kërkohet	-
	14, 22, 26		A) Nuk kërkohet ose B) Ventilimi gjenerik lokal i shkarkimit të tymit	- 78 %
	5, 8b, 9		A) ventilimi i përgjithshëm ose B) Ventilimi gjenerik lokal i shkarkimit të tymit	17 % 78 %
Prodhimet industriale të suspensionit të lagësht të ndërtesës hidraulike dhe materialeve ndërtimore.	7		A) Nuk kërkohet ose B) Ventilimi gjenerik lokal i shkarkimit të tymit	- 78 %
	2, 5, 8b, 9, 10, 13, 14		Nuk kërkohet	-
Përdorimi profesional i ndërtesës së thatë hidraulike dhe materialeve ndërtimore (brenda, jashtë)	2		Nuk kërkohet	-
	9, 26		A) Nuk kërkohet ose B) Ventilimi gjenerik lokal i shkarkimit të tymit	- 72 %
	5, 8a, 8b, 14	A) Nuk kërkohet ose B) Ventilimi i integruar lokal i shkarkimit të tymit	- 87 %	
	19	Kontrollet e lokalizuara nuk zbatohen, përpunimi vetëm në dhoma mirë të ventiluara ose jashtë.	-	
Prodhimet profesionale të suspensionit të lagësht të ndërtesës	11	A) Nuk kërkohet ose B) Ventilimi gjenerik lokal i shkarkimit të	- 72 %	

hidraulike dhe materialeve ndërtimore.		tymit	
	2, 5, 8a, 8b, 9, 10,	Nuk kërkohet	-

13, 14,
19

* PROC's janë përdorimet e identifikuara dhe të përkufizuara në pjesën 16.2.

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Versioni i rishikuar: 1/1 qershor, 2017 Data e printimit: 20 qershor, 2017

B) Kontrollat e duhura inxhinjrike – pluhuri i qyngjit dhe klinkeri: njëjtë si çimentoja.

C) Kontrollat e duhura inxhinjrike - materialet që ndihmojnë bluarjen dhe agjenti zvogëlues: Nuk është relevante sepse

koncentrimet e këtyre substancave janë nën kufizimet e koncentrimin të përcaktuara në CLP 1272/2008 (shikoni pikën 3).

8.2.2 Masat e mbrojtjes individuale të tilla si pajisjet për mbrojtje personale Të

përgjithshme: Gjatë punës shmanguni gjunjëzimit në llaç të freskët ose beton kurdo që është e mundur. Nëse gjunjëzimi është absolutisht

i nevojshëm atëherë pajisjet e duhura personale rezistente ndaj ujit duhet të përdoren. Mos hani, pini, ose konsumoni

cigare kur punoni me çimento për t'ju shmangur kontaktit me lëkurë ose gojë. Para fillimit të punës me çimento,

përdorni krem dhe e ripërdorni në intervale të rregullta kohore Menjëherë pas punës me çimento ose materiale që përmbajnë çimento, punëtorët duhet të lahen ose përdorin losion për lëkurë Largoni veshjet, mbathjet, orat e kontaminuara dhe pastroni shumë para se t'i ripërdorni.

Mbrojtja e syve/fytyrës



Përdorni syzet e aprovuara ose syzet e sigurisë sipas EN 166 kur të manipuloni me çimento të thatë ose të lagësht për parandalimin e kontaktit me sy.

Mbrojtja e lëkurës



Përdorni syze mbrojtëse që i rezistojnë ujit dhe alkalineve (p.sh. syze me pambuk të zhytur në nitril me shenjën CE) që nga brenda është i vijëzuar me pambuk; çizme; rroba mbrojtëse me mëngë të gjata si dhe produkte për kujdes të lëkurës (p.sh. kremja) për mbrojtjen e lëkurës nga kontakti i vazhdueshëm me çimenton e lagësht. Kujdes i veçantë duhet të kushtohet për tu siguruar që çimentoja e lagësht mos të futet në çizme Për syzet, duhet të respektohet koha maksimale e mbajtjes së tyre për shmangien e problemeve me lëkurë.

Në disa rrethana, të tilla kur shtrohet betoni ose perdahi, pantallonat ose kapakët e gjunjëve që i rezistojnë ujit janë të domosdoshme.

Ekzaminimet kanë treguar që syzet me pambuk të zhytur në nitril (trashësia e shtresës ca. 0.15 mm) me shenjimin CE, nga brenda i vijëzuar me pambuk, ofrojnë një mbrojtje të mjaftueshme për 480 min. Ndërroni syzet e lagështa. Mbani të gatshme dorezat për t'i ndërruar.

Mbrojtja respirative



Kur një person mund t'i ekspozohet niveleve të pluhurit përmbi kufijve të ekspozimit, përdorni mbrojtje të duhur respirative. Lloji i mbrojtjes respirative duhet të zbatohet për nivelin e pluhurit dhe të jetë në pajtim me standardin relevant EN, (p.sh. EN 149, EN 140, EN 14387, EN 1827) ose standardin nacional.

Rreziqet termike

Nuk zbatohet.

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Versioni i rishikuar: 1/1 qershor, 2017 Data e printimit: 20 qershor, 2017

A) Masat për mbrojtje individuale të tilla si pajisjet për mbrojtje personale - çimentoja: inhalimi DNEL prej 10 mg/m³

Për dori mi	PROC*	Ekspozimi	Specifikimi i pajisjeve për mbrojtje respirative (RPE)	RPE ^a prote
Prodhimi industrial/formulimi i ndërtesës hidraulike dhe materialeve ndërtimore.	2, 3	Kohëzgjatja nuk kufizohet (deri 480 minuta për ndërrim, 5 ndërrime në javë)	Nuk kërkohet	-
	14, 26		A) Maska FFP1 ose B) Nuk kërkohet	APF = -
	5, 8b, 9		A) Maska FFP2 ose B) maska FFP1	APF = APF =
Përdorimet industriale të ndërtesës së thatë hidraulike dhe materialeve ndërtimore (brenda, jashtë)	2		Nuk kërkohet	-
	14, 22, 26		A) Maska FFP1 ose B) Nuk kërkohet	APF = -
	5, 8b, 9		A) Maska FFP2 ose B) maska FFP1	APF = APF =
Prodhimet industriale të suspensionit të lagësht të ndërtesës hidraulike dhe materialeve ndërtimore.	7		A) Maska FFP1 ose B) Nuk kërkohet	APF = -
	2, 5, 8b, 9, 10, 13, 14		Nuk kërkohet	-
	2		Maska FFP1	APF =

Përdorimi profesional i ndërtesës së thatë hidraulike dhe materialeve ndërtimore (brenda, jashtë)	9, 26	A) Maska FFP2 ose B) Maska FFP1	APF = 10 APF = 4
	5, 8a, 8b, 14	A) Maska FFP3 ose B) Maska FFP1	APF = 20 APF = 4
	19	Maska FFP2	APF = 10
Prodhimet profesionale të suspensionit të lagësht të ndërtesës hidraulike dhe materialeve ndërtimore.	11	A) Maska FFP2 ose B) Maska FFP1	APF = 10 APF = 4
	2, 5, 8a, 8b, 9, 10, 13, 14, 19	Nuk kërkohet	-

* PROC's janë përdorimet e identifikuara dhe të përkufizuara në pjesën 16.2.

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Versioni i rishikuar: 1/1 qershor, 2017 Data e printimit: 20 qershor, 2017

Një pasqyrë e APF-ve të RPE të ndryshme (sipas EN 529:2005) mund të gjenden në fjalorin e MEASE (16).

Çdo RPE si në përshkrimin e mësipërm do të përdoret nëse parimet në vijim zbatohen paralelisht: kohëzgjatja e punës (krahasuar me "kohëzgjatjen e ekspozimit" si më lart) duhet të pasqyrojë stresin fiziologjik shtesë për punëtorin për shkak të rezistencës së frymëmarrjes dhe masës së vet RPE, për shkak të stresik të rritur termik nga mbulimi i kokës. Për më tepër, do të konsiderohet që aftësia e punëtorit për përdorimin e mjeteve dhe komunikimin zvogëlohen gjatë mbajtjes së RPE. Për arsyt e mësipërme, punëtori duhet të jetë (i) i shëndetshëm (posaçërisht marrë parasysh problemet mjekësore që mund të ndikojnë në përdorimin e RPE), (ii) kanë karakteristika të fytyrës që zvogëlojnë rrjedhje mes fytyrës dhe maskës (për shkak të vragave dhe qimeve në fytyrë). Pajisjet e rekomanduara më lartë që mbështeten në mbulimin e shtrëngueshëm të fytyrës nuk do të ofrojnë mbrojtje të nevojshme përveç nëse ata i përshtaten konturave të fytyrës në mënyrë të duhur dhe të sigurt. Punëdhënësi dhe personat e vet-punësuar kanë përgjegjësi ligjore për mirëmbajtje dhe zbatim të pajisjeve për mbrojtje respirative dhe menaxhimin e përdorimit të tyre të duhur në vend të punës. Prandaj, ato duhet të përkufizojnë dhe dokumentojnë një politikë të përshtatshme për një program për pajisjet e mbrojtjes respirative përfshirë trajnimin e punëtorëve.

B) Masat e mbrojtjes individuale të tilla si pajisjet për mbrojtje personale - pluhuri i qyngjtit dhe klinkeri:

njëjtë sikurse çimentoja.

C) Masat e mbrojtjes individuale të tilla si pajisjet për mbrojtje personale - materiali për ta ndihmuar bluarjen dhe agjentin

zvogëlues: Nuk është relevante sepse përqendrimet e këtyre substancave janë nën kufijtë e përqendrimet të përcaktuara në CLP 1272 / 2008 (shikoni pikën 3).

8.2.3 Kontrollat e ekspozimit mjedisor

Ajri: Kontrolli i ekspozimit mjedisor për emetimin e grimcave të çimentos në ajër duhet të jetë në pajtim me teknologjinë dhe rregulloret në dispozicion për emetimin e grimcave të pluhurit.

Uji: Mos e derdhni çimenton në sistemet e kanalizimit ose në trupat ujor, për ta shmangur pH-në e lartë Përmbi pH 9

ndikimet negative ekotoksikologjike janë të mundshme.

Kontrolli i ekspozimit mjedisor është relevant për mjedisin ujor si emetime të çimentove në fazat e ndryshme të ciklit jetësor (prodhimi dhe përdorimi) kryesisht zbatohen në ujërat tokësore dhe të zeza. Efekti ujor dhe vlerësimi i rrezikut mbulon efektin ndaj organizmave/ekosistemeve për shkak të ndryshimeve të mundshme të pH lidhur me shkarkimet hidrokside Toksiciteti i joneve tjera të tretura inorganike pritet të jetë i vogël në krahasim me efektin e mundshëm të pH.

pH i mbeturinave të lëngshme dhe ujit sipërfaqësor nuk duhet ta tejkalojë 9. Përndryshe mund të ketë ndikim në impiantet

Komunale për trajtimin e kanalizimit (STPs) dhe impiantet për trajtimin e ujit dhe mbeturinave industriale (WWTPs). Për këtë vlerësim të ekspozimit, një qasje përmes hapave rekomandohet:

Rreshti 1: Marrja e informacioneve për pH e mbeturinave të lëngshme dhe kontributi i çimentos në pH-në e fituar Nëse pH

është më i lartë se 9 dhe në masë të madhe i atribuohet çimentos, veprimet e mëtejme nevojiten për ta demonstruar përdorimin e sigurt.

Rreshti 2: Marrja e informacioneve për pH e ujit të pranuar pas pikës së shkarkimit. pH i ujit të pranuar nuk duhet ta tejkalojë vlerën 9.

Rreshti 3: Të matet pH në ujin e pranuar pas pikës së shkarkimit. Nëse pH është nën 9, përdorimin i sigurt demonstron në mënyrë të arsyeshme. Nëse pH është përtej 9, masat për menaxhimin e rrezikut duhet të zbatohen: mbeturinat e lëngshme duhet t'i nënshtrohen neutralizimit, për të siguruar përdorim të sigurt të çimentos gjatë fazës së prodhimit ose përdorimit.

FLETA E TË DHËNAVE PËR SIGURINË

Sipas Rregullores (EC)Nr. 1907/2006 (REACH) e pershtatur me UA- MMPH 18/2017

Produkti: Çimentoja

Versioni i rishikuar: 1/1 qershor, 2017 Data e printimit: 20 qershor, 2017

Toka dhe mjedisi tokësor: Nuk janë të nevojshme masa të veçanta për kontrollin e emetimit për ekspozim ndaj mjedisit tokësor.

9. KARAKTERISTIKAT FIZIKE DHE KIMIKE

9.1 Informacionet për karakteristikat themelore fizike dhe kimike

Këto informacione zbatohen për tërë përzierjen:

- ✓ Dukja: Çimentoja e thatë është një material inorganik i ngurtë tokësor (pluhur i hirtë ose i bardhë). Madhësia kryesore e grimcave: 5-30 µm
- ✓ (Era: Pa erë:
- ✓ Pragu i erës: Nuk ka prag të erës, pa erë
- ✓ pH: (T = 20°C në ujë, proporcioni ujë-masë e ngurtë 1:2): 11-13,5
- ✓ Pika e shkrirjes: > 1 250 °C
- ✓ Pika fillestare e vlimit dhe kufiri i vlimit: Nuk zbatohet pasi që nën kushte normale atmosferike, pika e

shkrirjes >1 250°C

- ✓ Pika e ndezjes Nuk zbatohet pasi që nuk është lëng
- ✓ Shkalla e avullimit: Nuk zbatohet pasi që nuk është lëng
- ✓ Shkalla e djegies (masë e ngurtë, e gaztë): Nuk zbatohet pasi që është masë e ngurtë që nuk digjet dhe nuk shkakton ose kontribuon

në zjarr përmes fërkimit

- ✓ Kufijtë e sipërm/të ulët të djegies ose shpërthimit: Nuk zbatohet pasi që nuk është gaz djegës
- ✓ Presioni i avullit: Nuk zbatohet pasi që pika e shkrirjes > 1250 °C
- ✓ Dendësia e avullit: Nuk zbatohet pasi që pika e shkrirjes > 1250 °C
- ✓ Dendësia relative: 2.75-3.20;
- ✓ Dendësia e dukshme: 0.9-1.5 g/cm³
